

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istog Municipality of Istog
	Nr. 11-69/20	Dt. 15.07.2020	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH -së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës së Lagjes DUSHKAJA të cilën e përfaqëson Arlind Bajramaj me nr. të kërkesës 11-351-19223 të datës 16.07.2020, për lëshimin e Lejës ndërtimore me karakter të përkohshëm për **Rregullimin e pjesës së sheshit të lagjes – Parku në Lagjen DUSHKAJA në Istog**, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

L E J E N D Ë R T I M I

1. Investitorit Komuna e Istogut në bazë të neneve 17 dhe 23 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174, për zbatimin e ligjit për Planifikim Hapësinor mbi kushtet e lokacionit i lejohet **Ndërtimin e objektit – Parku në Lagjen DUSHKAJA në Istog** e përkufizuar sipas projekt propozimit nga investitori në pjesën e parcelës kadastrale nr. 00292-1 evidentuar në Certifikatën me nr. zyrtare/2020 Zona Kadastrale Istog,
2. *Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është edhe dokumentacioni paraprak*
 - Certifikata e pronës
 - Aplikacioni i kushteve ndërtimore
 - Skicë projekti me pajisje dhe infrastrukturë urbane
3. Investitori lirohet nga taksat administrative, rregullores për Infrastrukturë 1/2019.
4. Investuesi është i obliguar:
 - Të siguroj shënimin e parcelës ndërtimore, vijës së rregullimit, nivelimit dhe vijës ndërtimore nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis
 - Ta lajmëroj inspektorët ndërtimor pranë Drejtorisë për Inspektim për ditën e fillimit të punës së paku 8 ditë para fillimit të ndërtimit.
 - Pas kryerjes së objektit e më së voni në afat prej 30 ditësh ta paraqesë kërkesën për kontrollim teknik të objektit të përfunduar në mënyrë që të pajiset me leje për përdorimin e tij.
 - Të lejohen inspektorët që të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes së ndërtimit për objektin të cilin është dhënë leja e ndërtimit se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve urbanistike-teknike të caktuara.

5. Kjo leje e ndërtimit vlen vetëm për ndërtimin e objektit investues **Rregullimi i jashtëm i Parkut në Lagjen DUSHKAJA në Istog sipas skicë projektit.**

6. Leja e ndërtimit është e vlefshme në periudhën për dy vjet nga dita e pranimit të aktvendimit.

7. Parku nuk mund të shfrytëzohet në të ardhmen si aset i investitorit por vetëm hapësirë e lirë për pushim dhe rekreacion të qytetarëve.

A R S Y E T I M

Investitori *Lagja DUSHKAJA* të cilën e përfaqëson *Arlind Bajramaj*, Komuna e Istogut me kërkesën 11-351-19223 të datës 16.07.2020 i është drejtuar kësaj Drejtorie për dhënjen e Lejës ndërtimore të objektit investues- **Rregullimi dhe Ndërtimi i parkut në Lagjen DUSHKAJA në Istog**, në pjesën e parcelën kadastrale nr. 00292-1 evidentuar në Certifikatën me nr. zyrtare/2020 Zona Kadastrale Istog, të përshkruar në pikën një të dispozitës të këtij Aktvendimi.

Bashkangjitur me kërkesën investitori ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Projektin kryesor në tri kopje identike.
- Provën mbi të drejtën e pronësisë apo shfrytëzimit të ngastrës të kadastrave nr. 745-0 dhe 746-0 evidentuar në Certifikatën me nr. 600/2020 Zona Kadastrave Istog të lëshuar nga DGJK në Istog. Drejtoria e Planifikimit urban dhe Mjedis, duke shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të prezantuar, ka vërtetuar se investitori ka prezantuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativin ligjor, nga lëmi i ndërtimit dhe se i njëjti është në harmoni me kushtet urbanistik-teknike dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzime juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë MMPH në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur që nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes këtij organi.

Planer urban
ark. Rexhep Blakaj, i.d.



Drejtori
Jashar Blakaj idn.

